

V E N D I M
Nr. 427, datë 12.9.2002

**PËR NJEHSIMIN E GRADAVE USHTARAKE ME FUNKSIONET ORGANIKE NË TË
GJITHA NIVELET E HIERARKISË SË KOMANDIMIT DHE TË DREJTIMIT TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 24 të ligjit 8670, datë 26.10.2000 "Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Njehsimin e gradave ushtarake me funksionet organike, në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm, repartet dhe institucionet (autonome) në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, njehsohen me funksionet organike të përcaktuara në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Gradat ushtarake për ushtarakët që shërbejnë në Forcat Tokësore dhe repartet në varësi të tyre, njehsohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Forcat Detare dhe repartet në varësi të tyre, njehsohen me funksionet organike të përcaktuara në lidhjen nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Forcat Ajrore dhe repartet në varësi të tyre, njehsohen me funksionet organike të përcaktuara në lidhjen nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Komandën e Mbështetjes Logjistike dhe repartet në varësi të saj, njehsohen me funksionet organike të përcaktuara në lidhjen nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Gradat ushtarake, për ushtarakët që shërbejnë në Komandën e Doktrinave dhe të Stërvitjes dhe repartet në varësi të saj, njehsohen me funksionet organike, të përcaktuara në lidhjen nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, për çdo gradë ushtarake, t'u jepet një shpërblim mujor në masën e përcaktuar në lidhjen nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Masa e shpërblimit mujor për gradë, të rritet sa herë dhe në të njëjtin raport me rritjen e pagave të ushtarakëve të Forcave të Armatosura.

9. Njehsimi i gradave ushtarake me funksionet organike, në të gjitha nivelet e hierarkisë së komandimit e të drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përfundojë brenda vitit 2003.

10. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për nxjerrjen e akteve të nevojshme në zbatim të këtij vendimi.

11. Vendimi nr.351, datë 1.8.1994 i Këshillit të Ministrave "Për vendosjen e gradave në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2003.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano